



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA KOMERCIALE**

---

Numri i lëndës: 2020:058867  
Datë: 25.04.2024  
Numri i dokumentit: 05620252

KE.nr.731/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen juridike të paditësit D.P.T “Trimi”, me pronar N.I.O. me seli në Vushtrri, Rr. “Dëshmorët e Kombit”, pa numër me NUI 810212944 kundër të paditurës Kompania për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS ) – Departamenti për konsumatorë - distrikti Mitrovicë me objekt kontesti shlyerje e borxhit pas mbajtjes së seancës gjyqësore të datës 02.04.2024, me datën 25.04.2024, jashtë seancës merr këtë:

**A K T V E N D I M**

I. Gjykata Komeriale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, shpallet jo kompetente në pikëpamje lëndore, për të vendosur sipas padisë së paditësit D.P.T “Trimi”, me pronar N.I.O. me seli në Vushtrri, Rr. “Dëshmorët e Kombit”, pa numër me NUI 810212944, e datës 05.01.2015, kundër të paditurës Kompania për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS ) – Departamenti për konsumatorë - distrikti Mitrovicë.

II. SHPALLEN TË PAVLEFSHME të gjitha veprimet procedurale të kryera nga ana e kësaj gjykate në këtë çështje kontestuese.

III. HEDHET SI E PALEJUAR padia e paditësit D.P.T “Trimi”, me numër të lëndës KE.Nr.731/22. e datës 05.01.2015 kundër të paditurës Kompanisë për Distribuim dhe Furnizim

me Energji Elektrike (KEDS ) – Departamenti për konsumatorë - distrikti Mitrovicë, lidhur me çështjen kthimi i borxhit.

### A r s y e t i m

Paditësi D.P.T “Trimi”, me pronar N.I.O. me seli në Vushtrri, Rr. “Dëshmorët e Kombit”, pa numër me NUI 810212944 ka ushtruar padi në këtë gjykatë me datën 05.01.2015 kundër të paditurës Kompanisë për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS ) – Departamenti për konsumatorë - distrikti Mitrovicë, lidhur me çështjen kthimi i borxhit.

Gjykata pasi bëri shqyrtimin paraprak të padisë ka ftuar palët ndërgjyqëse në seancën e datës 02.04.2024, në të cilën e paditura KEDS e ka kundërshtuar padinë duke theksuar së e njëjta është e pa lejuar pasi objekti i kontestit ka të bëjë me çështjen administrative e jo me çështje gjyqësore. Pasi gjykata vlerësoi deklaratimet e të paditurës gjeti se çështja e cila është objekt i kontestit përfaqëson çështje administrative, për vendosjen e së cilës kjo gjykatë nuk ka kompetencë lëndore, por që për vendosjen e këtij kontesti është kompetent Zyra e Rregullatorit për Energji, kjo nga arsyet në vijim: Sipas Ligjit Nr. 03/L-185 Për Rregullatorin e Energjisë, me nenin 16 par. 1 pika 3 është paraparë që Zyra e Rregullatorit për Energjinë ka kompetencat për zgjidhjen e kontesteve në sektorin e energjisë, përfshirë edhe ankesat në lidhje me qasjen e palës së tretë në sistemin e transmisionit apo shpërndarjes së energjisë elektrike. Ndërsa me nenin 25 par. 1 pika e të njëjtit ligj, Zyra e Rregullatorit ka kompetencë që të nxjerrë vendime për zgjidhjen e kontesteve sipas nenit 16 të këtij ligji. Me nenin 25 par 3 të po këtij ligji është paraparë se: *“aktet individuale të lëshuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji në bazë të paragrafit 1 të këtij neni, i nënshtrohen procedurave të shqyrtimit administrativ brenda Zyrës së Rregullatorit për Energji. Pas përfundimit të procedurës së shqyrtimit administrativ, pala e pakënaqur mund të fillojë procedurën administrative për zgjidhjen e kontestit në gjykatën kompetente në Kosovë, në pajtim me nenin 43 të këtij ligji dhe me Ligjin mbi Procedurën Administrative”*. Edhe sipas Rregullit për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë të hartuar nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë me datën 29.08.2011, me neni 18 pika 5 është paraparë që kundër vendimeve të Bordit të ZRRE-së konsumatorët apo të licencuarit mund të iniciojnë konflikt administrativ në gjykatën kompetente brenda (30) ditësh kalendarike nga data e pranimit të vendimit apo publikimit në faqen zyrtare elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit. Mbi bazën e të dhënave si më lart, rezulton se kjo gjykatë është jo kompetente për vendosjen lidhur

me kërkesën e paditësit, prandaj për këtë arsye, e në bazë të neneve 17, 18, 19, 29 dhe lidhur me nenin 391 par. 1 pika “a” e LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga të cekurat në kuptim të dispozitës së nenit 17, 18.1, 18.2, 19 dhe 391 të LPK-së , vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.731/22, datë 25.04.2024

Gjyqtari:

Alajdin Tërshnjaku

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit në Dhomat e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.